



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.143/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Faton Ademi dhe Afijete Sada - Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTENEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.143/2019, e datës 30.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTENEWS KOSOVA, ndaj subjektit politik Lista Serbe, lidhur me vendosjen e posterëve të kandidatit të tyre.

### A r s y e t i m

Me datën 30.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 29.09.2019, rreth orës 15:30, në afërsi të shkollës fillore “Staja Markovic” në Shtërpçë, janë vendosur disa poster të subjektit politik, Lista Serbe, dhe në të njëjtin objekt gjindet edhe shkolla e mesme Jovan Cfejjic. Ky veprim i subjektit politik sipas paraqitësit të ankesës është në kundërshtim me nenin 33 pika b, të LZP-së, si dhe me Rregullën zgjedhore 13/2013, dhe Kodin për Mirësjellje të subjekteve politike.

Subjekti politik Lista Serbe, në përgjigjjen në ankesë, theksojnë se ankesa është e pabazuar, pasi që posterët nuk janë të vendosur në vendin dhe në diametrim 100 metra nga hyrja e shkollës, ashtu si pabazë theksohet në ankesë. Përgjegjës në ankesë, si dëshmi i ka bashkangjitur 3 fotografi, me të cilat dëshmojnë se kanë larguar posterët, e vendosura në afërsi të këtyre objekteve. Kërkon që PZAP-i që ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTENEWS KOSOVA, ta refuzoj si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lista Serbe, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që këto veprime të subjektit politik Lista Serbe, nuk janë në kundërshtim me nenin 85.1 të LZP-së. Kjo për

faktin se, veprimet e parashtruara në ankesë janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve në qoftë se ajo shkolle gjate ditës se zgjedhjeve shërben si Qendër e Votimit ku sipas nenit 85.1 të LZP-së, parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KKV-ve, ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet kjo dispozitë ligjore është 24 orë para votimit dhe gjatë ditës së votimit, kurse ankesa është parashtruar gjatë fushatës zgjedhore, Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës, se këto veprime të subjektit politik, përbëjnë shkelje të Rregullës Zgjedhore 13/2013, dhe shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga subjekti politik Lista Serbe, andaj ankesën e ankuesit e refuzoj si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.143/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
**Adnan Konushevc**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***